

## MAPO ONLINE

<http://www.mapo.al/2012/03/05/me-teme-nga-historia-mesazh-per-te-gjitha-kohet/>

## Me temë nga historia, mesazh për të gjitha kohët

Preç Zogaj

“Gjendja njerëzore” konsiderohet vepra letrare më e mirë e shkrimtarit francez Andre Malraux (1901-1974). Njëkohësisht, një nga romanet më të mirë të letërsisë europiane të gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë. Ky roman u botua për herë të parë në vitin 1933, duke konfirmuar ardhjen e një shkrimtari të ri shumë të talentuar, që mendohej se do ta kishte të sigurt ngjitjen drejt majave më të larta të prozës moderne. “Gjendja njerëzore” fitoi çmimin “Gonkur”, më i larti që ka pasur e ka



Franca për veprat e shkrimtarëve francezë. Duke vlerësuar këtë libër që autori e shkroi në moshë të re, rreth të tridhjetave, shumë kritikë, botues, gazetarë, intelektualë dhe lexues të kualifikuar nuk kishin hezitime të vinin bast se në një të ardhme më të largët Malraux do të fitonte çmimin “Nobel”. Në fakt, jeta do të rridhte me shumë thyerje dhe të papritura për këtë shkrimtar. Në traditën e intelektualëve të angazhuar, ai do të impenjohej, pa e braktisur tempullin e letërsisë, në vorbullën e lëvizjeve më të spikatura politike dhe shoqërore të

kohës, do të bëhej një zë autoritar i elitës franceze dhe europiane, do të merrte pjesë në Rezistencën antinaziste, pastaj, me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, do të vihej përkrah Presidentit legjendar Charl De Gol, si një nga miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij më besnikë e më të ngushtë në përballimin e sfidave të Francës së Lirë. Andre Malraux ishte përgjatë një dekade ministri i Kulturës i qeverive të De Gol-it. Ai e themeloi këtë institucion që nuk kishte ekzistuar në traditën e qeverive të mëparshme republikane apo monarkiste të Francës dhe botës mbarë. Ndërkohë, paralel me punët e mëdha si zyrtar i lartë degolist, nuk pushoi se shkruari letërsi, ese, studime. Ai e derdhi dhuntinë e jashtëzakonshme të oratorisë në fjalimet e famshme të përkujtimin apo rivlerësimit të heronjve, shkrimtarëve dhe artistëve të mëdhenj të Francës. Në këto fjalime funebër, që janë botuar në një libër të veçantë, Malraux mori jehonat e oratorisë romake dhe “shpiku” një zë të ri të Francës së lavdisë, madhështisë dhe humanizmit. Ai vetë u bë një prej identiteteve më të spikatura të Francës dhe Europës së re.

Ndërkaq, viti 1933 mbeti deri në fund dhe qëndron sot e gjithë ditën një pikë shumë e lartë në karrierën e pasur dhe të stuhishme letrare të këtij shkrimtari dhe intelektualit të rrallë. Ky është viti i romanit “Gjendje njerëzore”, që tashmë pas kaq dekadash ka ardhur në shqip nga **shtëpia botuese “Toena” në përkthimin e Amantia Kapos.**

# Revue de presse : Condition humaine

---

Subjekti, vendi dhe koha ku ndodhin ngjarjet e larmishme dhe dramatike të këtij libri na çojnë në Kinën e fundit të viteve njëzet të shekullit të kaluar, kur forcat nacionaliste të Gomindanit të komanduara nga Çan Kaj Shi dhe komunistët e punëtorë të drejtuar nga Moska sovjetike dhe Kominterni, ishin ngritur së bashku kundër sundimtarëve të Kinës dhe pushtetit të koncesioneve perëndimore. Ky revolucion i çuditshëm ku dy forca në thelb armike- Gomindani dhe Partia Komuniste- kishin bashkuar taktikisht armët për një qëllim imediat të përbashkët, do të ngrinte në triumfin e vet siparin e një gjakderdhjeje të re. Në 12 prill 1927 forcat e Çan Kaj Shisë do të drejtonin armët kundër punëtorëve dhe komunistëve, duke vrarë mijëra prej tyre. Në këtë teatër të përgjakshëm investitorët e mëdhenj të Perëndimit në Kinë do të mbanin krahun e Gomindanit, kurse shumë evropianë të tjerë, majtistë dhe idealistë të frymëzuar nga revolucioni leninist i Tetorit 1917, do të bëheshin si mijëra revolucionarë kinezë viktima të grushtit të hekurt të forcave të Çan Kaj Shisë. Ky është sfondi historik i romanit “Gjendje njerëzore”. **Andre Malraux ka shkruar një libër për gjithë atë ndërthurje ngjarjesh, interesash dhe politikash që prodhuan shndërrimin e revolucionit në një luftë civile dhe instalimin e pushtetit të Gomindanit në Kinën e paraluftës së Dytë Botërore. Lexuesi mëson shumë nga ky roman për historinë parakomuniste të Kinës, por mrekullia e librit qëndron në aftësinë e autorit për të rrokur e pasqyruar këtë tablo të gjerë e komplekse përmes fateve njerëzore.** Linjës së historicizmit iu përgjigjen linjat e fateve që kanë personazhet. Përpjekjet, dramat, tragjeditë, dështimet e apo triumfet në jetën e tyre janë dhënë nga autori jo thjesht si rrjedhime të një revolucioni, por në një vështrim më të epërm e pa dyshim më të trishtuar, janë dhënë edhe si **pamje të gjendjes njerëzore në tokë, ku angazhimi i individit në Histori për një fat më të mirë konkurren ose më saktë zhurmohet e frenohet në anën tjetër nga koshienca e absurdit. Pse gjithë ky gjak? Pse gjithë këto jetë të flakura si lecka?- këto pyetje të ndjekin gjatë gjithë romanit si antistrofa e ngjarjeve atje.** Romani fillon me një vrasje. Revolucionari Çen vret në gjumë një trafikant armësh, që ndihmon armikun. Çeni është pjesë e një celule ku bëjnë pjesë edhe evropianët Kio dhe Katuni të mbështetur nga Klapiku. Pasi ndërgjegjësohen se forcat e Gomindanit po përparojnë drejt Shangait për të shtypur lëvizjen punëtoresh dhe vrarë drejtuesit komunistë, ata planifikojnë një atentat kundër Çan Kaj Shisë. Dështojnë në provën e parë. Në provën e dytë Çeni shkon i vetëm me bindjen për t’u hedhur në erë si kamikaz bashkë me veturën e gjeneralit . Sakrifika i shkon dëm pasi gjenerali nuk ka përdorur veturën e tij atë ditë. Atentati shfrytëzohet nga Gomindani për të ndërmarrë një valë të re terrori dhe vrasjesh. Hakmarrja do të bjerë mbi shokët e Çenit, mbi Kion dhe Katunin. Kio është biri i profesor Gisorit, një intelektual komunist me reputacionin e njeriut të urtë. Gisorit bën çmos ta nxjerrë të birin nga burgu i Gomindanit, por nuk ia del. Kio do të vdesë heroikisht me cianur, bashkë me disa revolucionarë të tjerë. Klapikut do t’i jepen dy ditë afat për t’u larguar nga Kina. Do të largohet përkohësisht edhe një personazh tjetër me peshë, Ferali, një industrialist francez që përfaqëson pushtetin e parasë në teatrin e ngjarjeve të romanit. Por edhe ky burrë shumë i pasur që zotëron Konsorciumin francez në Indokinë, do të këtë “rrëzimet” e tij në ultësirën e gjendjes njerëzore. Nuk është fjala këtu për kthesën e tij drejt pushtetit të padronit të ri të Kinës, Çan Kaj Shi, por për një dramë erotike që është futur gati-gati si një novelë më vete brenda romanit . **Dhimbja dhe vuajtjet e tij për ikjen e së dashurës, Valerisë, gjestet e tij të dëshpëruara në një qytet të mbushur me krisma, shpërthime dhe të vdekur, shpalosin në një anë egoizmin e plagosur të këtij burri, por edhe forcën supreme të dashurisë.**

Ndërsa rrjedh ngadalë si një kronikë e ftohtë lufte, romani mbahet në katër episode që ndërthejnë dramaticitetin e subjektit, gdhendjen e karaktereve, depërtimin mjeshëtor në psikologjinë e tyre. Këto episode, sipas meje janë: Atentati kundër Çan Kaj Shisë, Arrestimi dhe marrja në pyetje e Kio-s, Shpërthimi i Feralit, Vdekja e revolucionarëve. “Vdekje e ngopur nga ky bashkim vëllazëror, një asamble e dërmuar ku të gjithë njohin dëshmorët e tyre, legjendë e përgjakur në të cilën do të krijohet legjenda e artë”.

# Revue de presse : Condition humaine

---

Kështu shkruan Malraux, me një stil që e përcjell kaq të gjallë dramaticitetin e situatave sa lexuesit i bëhet se po i jeton vetë. **Shkruan shumë bukur, tregon shumë bukur, duke mbajtur mjeshtërisht në skenat kulmore ritmin dhe temporitmin e aksionit. Frazja e tij është plot tension dhe dritë, plot vërtetësi dhe ndjenjë. Teksti i pasur të fton në një lexim në disa nivele, të historisë, të epizmit, të absurdit dhe dëshpërimit. “Gjendje njerëzore” është vërtet një roman për revolucionin në Kinën e vitit 1927, por nga lënda jetësore e asaj kohe autori ka plazmuar një roman të hapur që nuk mbaron, që vazhdon bashkë me shoqërinë njerëzore.**

<http://www.vizionplus.tv>

## Andre Malraux vjen ne shqip

E diel, 15 Janar 2012 14:41



Andre Malraux

Protagonistja e vërtetë e romanit të tij është vdekja! Historia e revolucionareve kineze është konsideruar në vite ndër librat e shekullit, pasi “Gjendja Njerëzore” e shkrimtarit dhe politikanit

# Revue de presse : Condition humaine

---

Andre Malro, ish ministër i kulturës ne qeverinë De Gol, nuk është vetëm fitues i çmimit “Gonkur” ne vitin 1933, por një rrëfim qe shpesh është shndërruar edhe ne prodhim kinematografik.

---

I sjelle për here te pare ne shqip nga Amantia Kapo, edhe pse i publikuar vite me pare kudo ne bote, “Gjendja Njerëzore” ka përshkrime dhe personazhe autentike qe kane te bëjnë me rezistencën, e cila ne njëfarë mënyre lidhet drejtpërdrejt me autorin, qe ka qene protagonist jo vetëm ne dy luftërat botërore, por edhe ne luftën e Spanjës.